



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201801772/2

Tiranë ___/___/2018

Lënda: Rekomandime për marrjen e masave për përmirësimin e shërbimeve të ofruara për fëmijët me probleme të shëndetit mendor në Qendrën Kombëtare të Mirërritjes, Zhvillimit dhe Rehabilitimit të Fëmijëve.

MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

**DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË POLITIKAVE DHE
ZHVILLIMIT TË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE**

ZONJËS MERITA XHAFAJ

**QENDRËS KOMBËTARE TË MIRËRRITJES, ZHVILLIMIT DHE
REHABILITIMIT TË FËMIJËVE**

ZONJËS MIGENA KIKA

TIRANË

Institucioni i Avokatit të Popullit është pjesë e Rrjetit Evropian të Ombudspersonit për Fëmijët (ENOC). Misioni i rrjetit është promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të fëmijëve, në zbatim të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve.

Një ndër aktivitetet e Rrjetit Evropian të Ombudspersonit për Fëmijët (ENOC) është organizimi i konferencës vjetore, ku anëtarët diskutojnë praktikatat e tyre në drejtim të përmirësimit të të drejtave të fëmijëve në Evropë, në zbatim të Konventës së të Drejtave të Fëmijëve për një temë të caktuar.

Për vitin 2018, tema e përbashkët e punës është shëndeti mendor i fëmijëve dhe adoleshentëve. Përzgjedhja e temës nga rrjeti ka ardhur si rezultat i sfidave kryesore të identifikuara në këtë drejtim, të cilat konsistojnë në përmirësimin

e shërbimeve të kujdesit shëndetësor mendor për fëmijët dhe adoleshentët, promovimin e të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve në kujdesin shëndetësor, duke ndihmuar në ndryshimin e qëndrimeve ndaj çrregullimeve psikiatrike, si dhe duke luftuar stigmën ndaj tyre, sidomos te grupet e veçanta, si personat me aftësi të kufizuara, komunitetin LGBTI etj. Gjithashtu, edhe reduktimin e pabarazive territoriale dhe shoqërore, në mënyrë që të krijohet mundësia e mirëqenies së barabartë për të gjithë.

Për të dhënë një pasqyrë të situatës aktuale të vendit tonë, si anëtar i ENOC, institucioni i Avokatit të Popullit realizoi monitorimin dhe vlerësimin e kushteve të trajtimit të fëmijëve dhe adoleshentëve me probleme të shëndetit mendor në disa institucione, që ofrojnë shërbime të shëndetit mendor për fëmijët.

Konkretisht, Seksioni i Mbrojtjes dhe Promovimit të të Drejtave të Fëmijëve pranë institucionit të Avokatit të Popullit në datën 11.9.2018, kreu një inspektim të përgjithshëm në Qendrën Kombëtare të Mirërritjes, Zhvillimit dhe Rehabilitimit të fëmijëve.

Avokati i Popullit, pasi shqyrtoi informacionin nga monitorimi i realizuar, ka detyrimin kushtetues dhe ligjor, t'Ju parashtrojë përfundimet e këtij monitorimi, si më poshtë vijon.

Objektivat e inspektimit:

- vlerësimi i dokumentacionit, procedurave dhe personelit, në/dhe për zbatim të legjislacionit në fuqi;
- respektimi i të drejtave të fëmijëve në zbatim të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve.

Metodologjia

Grupi inspektues i institucionit të Avokatit të Popullit, i përbërë nga juristë dhe një punonjës social, si metodologji pune ka përdorur:

- së pari, zhvillimin e bisedave paraprake me drejtuesit e këtyre institucioneve, informacion i cili është hedhur në një formular standard për inspektimet e këtyre institucioneve;
- së dyti, zbatimin e akteve nënligjore në fushën e shëndetit mendor, në drejtim të respektimit të të drejtave të fëmijëve.
- së treti, monitorimin e mjediseve dhe kushteve të institucionit, ku ofrohen shërbimet për fëmijët me probleme të shëndetit mendor.

Në përfundim të inspektimit, grupi monitorues i institucionit të Avokatit të Popullit ka zhvilluar bisedën përmyllëse me drejtuesin e institucionit dhe stafin në shërbim të drejtëpërdrejtë me përfituesit, ku u adresuan problematikat e evidentuara gjatë inspektimit, si edhe rekomandimet përkatëse, të cilat gjenden të detajuar në fund të këtij raporti.

Më lejoni, t'Ju parashtroj ndërtimin strukturor dhe profilin e Qendrës Kombëtare të Mirërritjes, Zhvillimit dhe Rehabilitimit të Fëmijëve, si vijon:

Qendra Kombëtare e Mirërritjes, Zhvillimit dhe Rehabilitimit është krijuar me vendimin nr.325, datë 23.6.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e Qendrës Kombëtare "Për mirërritjen, zhvillimin dhe rehabilitimin e fëmijëve", si njësi buxhetore, e veçantë".

Në zbatim të këtij vendimi, statusi i kësaj qendre është ai i njësisë buxhetore, kombëtare, të veçantë, në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Financimi i qendrës realizohet nga fondet e buxhetit të shtetit, nëpërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Qendra ka statusin e një qendre kombëtare, që ofron shërbime mediko-sociale, nga një ekip multidisiplinar, për fëmijët me probleme të shëndetit motor dhe mendor, të grupmoshës nga 0-6 vjeç dhe mbulon të gjithë territorin e vendit.

Në zbatim të legjisllacionit në fuqi, rregulloret e brendshme të shërbimeve përfshijnë:

- rregullat e menaxhimit/drejtimit të shërbimit;
- misionin e shërbimit dhe funksionet bazë të tij;
- kriteret e shërbimit e pranimit dhe daljes nga shërbimi ku është e aplikueshme;
- rolet dhe përgjegjësitë e secilit rol profesional;
- kriteret e vlerësimit të parë: kush profesionist mund t'a kryejë dhe periudha kohore brenda të cilit duhet kryer;
- menaxhimin e dokumentacionit si: të regjistrave, kartelave klinike dhe formateve të ndryshme të vlerësimit, duke përfshirë dhe personat që janë të autorizuar të dokumentojnë dhe sigurimin e konfidencialitetit;
- procedurat e vlerësimit të rastit, të cilat duhet të përfshijnë:
 - i) vlerësimin e problematikës aktuale të individit ose nevojave të tij dhe kush nga profesionistët mund t'a kryejë ;
 - ii) vlerësimin, nëse shërbimi mund të ofrojë shërbime që adresojnë nevojat e individit ;
 - iii) si dhe referimet e mundshme.

Për sa më sipër, nga drejtuesi i QKMZHR-it, na u mundësua vënia në dispozicion e rregullores së brendshme të qendrës “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës Kombëtare të Mirërritjes, Zhvillimit dhe Rehabilitimit të Fëmijëve”, miratuar nga ministri i Shëndetësisë me urdhrin nr.65, prot, datë 1.7.2013.

Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson punën e bërë në zbatim të rregullores së miratuar, por nga analiza krahasuese e përmbajtes dhe detyrimeve të përcaktuara në aktet nënligjore në zbatim të ligjit nr.44/2012 “Për shëndetin mendor”, mungonin disa nga kriteret e përcaktuara në këto akte¹.

Të dhënat statistikore mbi numrin e përfituesve të kësaj qendre

Nga të dhënat zyrtare të marrë nga QKMZHR-it për vitin 2017, numri i fëmijëve që kanë marrë shërbime është 779 përfitues, ku 389 fëmijë janë nga zonat rurale dhe 390 fëmijë janë nga zonat urbane.

Nga numri total i përfituesve, janë hospitalizuar 632 fëmijë. Krahasuar me vitin 2016, kemi ulje me 30 shtrime. Gjatë kësaj periudhe, janë vlerësuar nga ekipi multidisiplinar 241 raste të reja dhe janë rivlerësuar 192 raste.

Kapaciteti i qendrës me shtretër për shërbimin e hospitalizimit është 30, përveç nënëva të cilat shoqërojnë fëmijët gjatë këtij procesi. Kohëzgjatja e hospitalizimit në qendër është 2 javë.

Gjatë realizimit të inspektimit, në qendër ofroheshin shërbime hospitalizimi për 22 fëmijës së bashku me nënat e tyre, si edhe shërbime ambulatorie për 192 fëmijë.

Burimet njerëzore

Struktura e QKMZHR është miratuar me urdhër të ministrit të Shëndetësisë dhe ka gjithsej 70 punonjës.

Organigrama e qendrës përbëhet nga 4 sektorë. Më konkretisht:

- Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Informacionit Shëndetësor;

¹ Paketa e akteve nënligjore në/dhe për zbatim të ligjit nr.44/2012, “Për shëndetin mendor”, botim i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Fondacionit Soros-Albania, dhjetor 2013. Konkretisht në rregulloren e shërbimeve të shëndetit mendor, të miratuar nga ministri i Shëndetësisë, në pikën 3.1.1/3, “Rregulloret e brendshme të shërbimeve të specializuara të shëndetit mendor”, përcaktohet se: “...*këto rregullore ndërmjet të tjerave duhet të përfshijnë edhe kriteret e shërbimit/përcaktimi i target grupit që i ofron shërbim të drejtëpërdrejt ose indirect, ose kriteret e pranimit dhe e daljes nga shërbimi ku është e aplikueshme...*”.

- Sektori i Shërbimeve dhe Financës;
- Sektori i Shërbimeve Mjekësore;
- Sektori i Edukimit dhe Rehabilitimit.

Administrimi i qendrës kryhet nga një drejtues dhe një nëndrejtor ekonomik. Çdo sektor administrohet nga një shef sektori. Gjithsej janë katër përgjegjës sektori, ku në përputhje me veprimtarinë e sektorit dhe profilin e punës, janë përcaktuar edhe profesionet përkatëse.

Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Informacionit Shëndetësor përbëhet nga 4 punonjës, 1 specialist i promocionit shëndetësor që mbulon edhe burimet njerëzore, një specialist i shëndetit mendor që mbulon statistikën, një specialist arkivist-protokollist, si edhe një specialist, nëpunës informacioni.

Sektori i Shërbimeve dhe Financës përbëhet 13 punonjës, ku një është përgjegjës sektori (ekonomist), një magazinier, një punëtor mirëmbajtës/kaldaist, 4 roje objekti, 1 kuzhinier, 2 pjatolarëse, 1 gardier/robaqepës/rrobararës, si edhe pesë sanitare.

Sektori i Shërbimeve Mjekësore përbëhet nga 20 punonjës, një përgjegjës sektori (mjek i profilizuar neuropediatër/pediatër), 2 mjekë të specializuar, një pediatër/neuropediatër dhe një psikiatër infantil, 4 psikologë, 1 kryeinfermier dhe 11 infermierë.

Sektori i Shërbimeve të Edukimit dhe Rehabilitimit përbëhet nga 19 punonjës, një përgjegjës sektori (profili punonjës sociale), 1 punonjës social, 8 terapistë zhvillimi (arsim i mesëm), 5 terapistë grupi (arsim i lartë), 5 fizioterapistë, 5 ergoterapistë dhe 4 logopedistë.

Shërbimet hospitalore ofrohen 24 orë në 24 orë, ndërsa shërbimet ambulatorë dhe shërbimet e rehabilitimit ofrohen nga ora 7.00 e mëngjesit deri në orën 7.00 të mbrëmjes.

Shërbimet e ofruara në këtë qendër janë:

- Diagnostikimi;
- Vlerësimin dhe hartimin e planit individual;
- Trajtimi ambulator dhe hospitalor për të gjithë fëmijët me probleme të shëndetit mendor;
- Shërbim i edukimit dhe rehabilitimit.

Fëmijët që marrin shërbime në këtë qendër, në zbatim të legjislacionit, referohen nga shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor.

Shërbimi i kujdesit shëndetësor parësor është shërbimi që ofrohet nga mjekët e familjes dhe personeli infermior, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në institucionet e kujdesit shëndetësor parësor, ku përfshihen edhe konsultoret. Shërbimi i kujdesit shëndetësor parësor bazohet në paketën bazë të shërbimit të kujdesit parësor dhe në sistemin e referimit, ku përfshihet edhe detyrimi i zbulimit, referimit dhe ndjekjes së pacientëve me çrregullime të shëndetit mendor.

Sipas kësaj pakete, shëndeti mendor është pjesë përbërëse e Kujdesit Shëndetësor Parësor. Ky shërbim asiston individë me çrregullime të shëndetit mendor dhe ndihmon në përmirësimin e gjendjes shoqërore (që është përcaktuese e shëndetit jo të mirë mendor) të pacientëve dhe familjeve të tyre. Mbështetja e dhënë në kujdesin parësor është pjesë e kujdesit gjithëpërfshirës të shëndetit mendor, ashtu si dhe pjesë thelbësore e kujdesit shëndetësor në përgjithësi.

Fëmijët referohen nga kujdesi shëndetësor parësor kur:

- paraqesin shenja të qëllimeve vetëvrasëse;
- vlerësimi nuk mund të realizohet në kushtet e kujdesit parësor, p.sh. simptoma psikotike, ADHD, etj;
- nevojitet mjekim dhe trajtim, që nuk realizohet në kushtet e kujdesit parësor (çrregullim depresiv tek fëmija, çrregullim i rëndë obsesivo-kompulsiv);
- shkalla e paaftësisë është e tillë që personi nuk mund të shkojë në shkollë apo të takojë shokët dhe miqtë;
- shfaqen shenja të neglizhimit ose abuzimit;
- kanë dështuar përpjekjet e mëparshme të KSHP.

Nga intervista e realizuar me drejtuesin e institucionit, për fëmijët e grupmoshës nga 0-6 vjeç, rastet referohen edhe nga Klinika Psikiatrike për Fëmijët dhe Adoleshentët në Klinikën Psikiatrike të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë.

Fëmijët e referuar diagnostikohen nga sektori i shërbimeve mjekësore, i cili në kartelën mjekësore jep edhe udhëzimet përkatëse për veprimet, që duhet të ndërmerren në vazhdimësi, për procesin e vlerësimit të rastit.

Në zbatim të legjislacionit në fuqi, procedura e vlerësimit të rastit, përfshin:

- vlerësimin e problematikës aktuale të individit ose nevojave të tij dhe, kush nga profesionistë mund ta kryejë ;
- vlerësimin, nëse shërbimi mund të ofrojë shërbime që adresojnë nevojat e individit ;
- si dhe referimet e mundshme.

Për çdo pacient (ku përfshihen edhe fëmijët), që referohet pranë shërbimeve të shëndetit mendor plotësohet një vlerësim, bazuar në procedurat e përshkruara në rregulloren e brendshme, para se të ofrohen shërbime. Ky vlerësim duhet të përmbajë elementët e vlerësimit gjithëpërfshirës në nivel bio-psiko-social, por jo vetëm, të tilla si:

- problemin aktual të pacientit;
- pikat e forta dhe nevojat e pacientit;
- diagnozën përkatëse, e cila duhet të përkufizohet brenda 30 ditëve nga kontakti i parë;
- historiku mjekësor, familjar dhe social;
- vlerësime të ndryshme psikiatrike, psikologjike ose sociale.

Shërbimi i edukimit dhe rehabilitimi është shërbimi që i ofrohet drejtëpërsëdrejti fëmijëve, nëpërmjet terapive të ndryshme të planifikuara nga ekipi multidisiplinar në kartelën individuale të çdo fëmije. Punonjësi social koordionon, këshillon dhe referon rastet, në përputhje me planin individual të çdo fëmije. Nga biseda e zhvilluar me punonjësin social, u informuam se familjet e fëmijëve kanë nivel të ulët arsimor dhe kulturor, vijnë nga familje me probleme të theksuara social-ekonomike e për rrjedhojë, nuk disponojnë informacion mbi të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuar. Këto problematika dukshëm transmetohen edhe në mungesën e kujdesit të fëmijëve në vazhdimësi, ku roli i faktorit social është i rëndësishëm në zhvillimin e këtyre fëmijëve. Gjithashtu, edhe nga bisedat e zhvilluara me nënat e fëmijëve, u informuam se shpesh herë hasin vështirësi në pranimin e fëmijëve nëpër çerdhe, kopshte në vendbanimet e tyre, si edhe kishin mungesë të njohurive lidhur me strukturat e ngritura pranë njësive administrative, të cilat merren me mbrojtjen e fëmijëve (NJMF).

Kopshti edukativo-terapeutik

Programet e zhvilluara në këtë shërbim janë të thjeshta, bazuar në nevojat e fëmijëve, ku këto programe mund të zhvillohet lehtësisht edhe nga prindërit në shtëpi. Qëllimi i këtij shërbimi mundëson socializimin mes fëmijëve, ndërveprimin e tyre, ku mësojnë të ndajnë lodrat dhe hapësirat. Ky shërbim përfshin edhe shpërndarjen e praktikave të mira, të cilat mund të realizohen

edhe në mjediset e shtëpisë nga prindërit. Vazhdimisht, prindërit këshillohen për t'i zhvilluar këto praktika me fëmijët, ku terapistët plotësojnë protokollat e vëzhgimit, të cilat bëhen pjesë e dosjeve të tyre.

Terapia e zhvillimit kryhet çdo ditë për fëmijët e hospitalizuar dhe disa herë në javë për fëmijët ambulator. Gjatë vitit 2017, janë trajtuar gjithsej 391 fëmijë, ku 25 fëmijë janë të mbartur nga viti 2016, 156 janë fëmijë ambulatorë dhe 235 fëmijë të hospitalizuar. Diagnozatat e fëmijëve, të cilët kanë marrë këtë shërbim janë të tilla si : autizëm, prapambetje mendore, etj. Progresi i zhvillimit të fëmijës gjatë ofrimit të këtij shërbimi bëhet pjesë e kartelës mjekësore të fëmijës.

Logopedia kryhet çdo ditë për fëmijët e hospitalizuar dhe disa herë në javë për fëmijët ambulatorë. Për vitin 2017, janë trajtuar 166 fëmijë, ku 79 fëmijë janë ambulatorë dhe 87 fëmijë janë të hospitalizuar. Diagnozatat e fëmijëve, të cilët kanë marrë këtë shërbim janë të tilla si : autizëm, prapambetje mendore, si dhe prapambetje gjuhësore, etj. Progresi ose regresi i zhvillimit të fëmijës gjatë ofrimit të këtij shërbimi bëhet pjesë e kartelës së fëmijës.

Ergoterapia kryhet çdo ditë për fëmijët e hospitalizuar dhe disa herë në javë për fëmijët ambulatorë. Për vitin 2017, janë trajtuar 266 fëmijë, ku 118 fëmijë janë ambulatorë dhe 148 fëmijë janë të hospitalizuar. Viti 2017 ka patur një rënie të numrit të fëmijëve që kanë marrë këtë shërbim, me 27 fëmijë. Diagnozatat e fëmijëve, të cilët kanë marrë këtë shërbim janë të tilla si : autizëm, paraliza cerebrale, hypotoni, prapambetje mendore, etj. Progresi i zhvillimit të fëmijës gjatë ofrimit të këtij shërbimi bëhet pjesë e kartelës mjekësore të fëmijës.

Fizioterapi, kryhet çdo ditë për fëmijët e hospitalizuar dhe disa herë në javë për fëmijët ambulatorë. Për vitin 2017, janë trajtuar 171 fëmijë, ku 73 fëmijë janë ambulatorë dhe 98 fëmijë janë të hospitalizuar. Diagnozatat e fëmijëve, të cilët kanë marrë këtë shërbim janë të tilla si : tetrapareze, hipotoni, hemipareze, autizëm, etj. Progresi i zhvillimit të fëmijës gjatë ofrimit të këtij shërbimi bëhet pjesë e kartelës së fëmijës.

Për gjitha shërbimet e ofruara më lart, ofrohet edhe këshillimi me prindërit, që këto shërbime të kryhen edhe prej tyre në mjediset e shtëpisë. Çdo profesionist, që ofron këto shërbime, harton planet e punës individuale për çdo fëmijë, ku në bashkëpunim edhe me prindërit, mundësojnë matjen e zhvillimit të fëmijës. Nga bisedat e zhvilluara me profesionsitët, u informuam se prindërit, pavarësisht interesit që shprehin dhe gadishmërisë për t'i ofruar këto shërbime, në vazhdimësi shohim një neglizhencë për t'i realizuar.

Mjediset e institucionit

Godina e Qendrës Kombëtare të Mirërritjes dhe Rehabilitimit është një ndërtesë e vjetër, tre kateshe e rikonstruksionuar nga Caritasi Zvicerian, në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Shëndetësisë. Në mjediset e jashtme, mbrapa godinës, oborri ishte i mirësishtuar me lodra dhe lulishte, mjedis në të cilin zhvilloheshin shumë aktivitete sociale dhe okupacionale.

Në katin e parë të godinës, ndodhej lavanderia, kuzhina dhe zyra e pritjes të fëmijëve, të cilët referoheshin nga kujdesi shëndetësor parësor ose nga klinika Psikiatrike për Fëmijët dhe Adolehentët në Klinikën Psikiatrike, të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, në përputhje me protokollin mjekësor.

Kuzhina është e pajisur me të gjitha pajisjet elektornike si: soba, frigorifer, apsirator dhe furrë pjekëse industriale. Investimet dhe pajisjet e kuzhinës janë realizuar nga Caritasi Zvicerian. Menuja javore ishte e afishuar në mur dhe e firmosur. Librezat shëndetësore të kuzhinierëve ishin të përditësuara. Kampionët ushqimorë ruheshin në kushte frigoriferike, por jo të mbyllur me çelës. Kuota ditore ushqimore për fëmijët e hospitalizuar së bashku me nënat ishte 240 (dyqind e dyzetë) lekë në ditë.

Lavanderia përmbushte të gjitha kushtet higjeno-sanitare dhe paisjet elektronike si: lavatriçia industriale (pavarësisht vjetërsisë), tharësja e rrobave, si dhe lavatriçet normale, të cilat plotësonin të gjitha nevojat e institucionit.

Në katin e dytë të godinës ndodheshin mjediset për këshillim individual të fëmijëve, të infermierisë, dhomat e hospitalizimit ku qëndronin fëmijët së bashku me nënat (mesatarisht 3-4 fëmijë në një dhomë së bashku me nënat), tualetet dhe dushet, si dhe menca (shërbim që ofrohej me ashensor ushqimi nga kuzhina).

Në katin e tretë ndodheshin zyrat e administratës së institucionit, dhoma e mjekëve të specializuar, dhoma e infermierëve, mjediset për terapi okupacionale, fizioterapi e vlerësimit të problematikave të fëmijëve dhe kutia përkatëse me mjetet e duhura (kukulla, kuba etj.), e ndërtuar sipas standardeve ndërkombëtare, kopshti edukativo-terapeutik, si edhe dhoma për hospitalizimin e fëmijëve, së bashku me nënat.

Nga vëzhgimet e kryera në institucion, vërehet, se pajisja e dhomave të hospitalizimit me mjete hotelerie të tilla si dollape, komodina nuk janë në përputhje me standardet e duhura. Po kështu, edhe lyerja e tyre duhet të jetë me ngjyra dhe figura të ndryshme, me qëllim krijimin e një mjedisi sa më të përshtatshëm për fëmijët.

Një element tjetër, i nevojshëm dhe i domosdoshëm, lidhur me shmangien e pengesave infrastrukturore, është vendosja e ashensorit pasi, mjedisi i fizioterapisë ndodhej në katin e tretë.

Përfundimet e inspektimit

Garantimi, që fëmijët të marrin kujdesin e duhur dhe në kohën e duhur, për shëndetin mendor dhe për të mbrojtur të drejtat e tyre gjatë kujdesit ose trajtimit, kërkon që mekanizmat e inspektimit dhe monitorimit të sigurojnë organin përgjegjës për çështjet e shëndetit mendor, për inspektimin e të gjitha shërbimeve të shëndetit mendor të fëmijëve, në baza periodike të rregullta.

Gjatë inspektimeve të realizuara nga institucioni i Avokatit të Popullit, në Qendrën Kombëtare të Mirëritjes dhe Zhvillimit e Rehabilitimit, ajo që konstatohet është si vijon:

- mungesa e ngritjes dhe zhvillimit të mëtejshëm të shërbimeve, bazuar në të dhëna, përmes hartimit dhe standardizimit të protokolleve të trajtimit dhe monitorimit të indikatorëve të cilësisë për fëmijët;
- mungesa e vazhdimësisë së shërbimeve të specializuara në mjediset e shtëpisë nga vetë prindërit, me qëllim garantimin e zhvillimit normal progresiv në interesin më të lartë të fëmijës.
- mungesa e informacionit nga ana e prindërve për strukturat përgjegjëse në nivel vendor për mbrojtjen e fëmijëve, për të garantuar vazhdimësinë e terapive nga shërbime të specializuara në nivel vendor dhe përfshirjen e tyre në institucionet e edukimit, çerdhe, kopshte, shkolla etj ;
- mungesa e shërbimeve të specializuara në nivel vendor për fëmijët me probleme të shëndetit, sidomos lidhur me fuqizimin e familjeve dhe këshillimin e tyre në vazhdimësi, për të mundësuar një mjedis të ngrohtë dhe familjar, për fëmijët me probleme të shëndetit mendor;
- mungesa e koordinimit, bashkëpunimit dhe bashkërendimit të punës, ndërmjet mekanizmave në nivel qendror dhe vendor të strukturave mjekësore, sociale dhe arsimore, për të garantuar, mbrojtur dhe integruar fëmijët dhe familjet e tyre në shoqëri;
- mungesa e veprimtarive promovuese dhe ndërgjegjësuese për strukturat përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor për fëmijët me probleme të shëndetit mendor.

Mbrojtja dhe forcimi i shëndetit mendor të fëmijëve nuk është vetëm një komponent kyç i promovimit të të drejtave të tyre, duke përfshirë interesin e tyre më të lartë, por ka edhe përparësi të jashtëzakonshme. Kjo u jep fëmijëve mundësinë më të mirë për të jetuar një jetë të shëndetshme dhe të përmbushur,

të rriten për të qenë adultë të lumtur dhe produktivë, u mundëson të jetojnë fëmijërinë e tyre, por passjell përfitime shumë të mëdha edhe për shoqërinë.

Për këtë qëllim, në mbështetje edhe të nenit 21, të ligjit nr.8454, datë 4.2.1999, "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar,

REKOMANDOJMË:

- marrjen e masave për hartimin e rregullores së funksionimit dhe organizimit të Qendrës Kombëtare të Mirërritjes, Zhvillimit dhe Rehabilitimit të Fëmijëve, në përputhje me paketën e akteve nënligjore n/dhe për zbatim të ligjit nr.44/2012 "Për shëndetin mendor";
- marrjen e masave për rritjen e kuotës ushqimore ditore për fëmijët, si edhe përfshirjen e nënave si përfituese të këtij shërbimi në këtë institucion;
- marrjen e masave për përmirësimin e dhomave të hospitalizimit të fëmijëve, duke krijuar mjedise të ngrohta dhe miqësore për ta;
- marrjen e masave për vendosjen e ashensorit në godinë, për të shmangur barrierat infrastrukturore të fëmijëve, që marrin shërbimin e fizioterapisë;
- sektori i Shëndetit Mendor dhe Adiktologjisë në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale duhet të fuqizohet në ushtrimin e rolit të tij si drejtues i procesit të zbatimit të politikave dhe strategjive të shëndetit mendor, në përputhje me legjislacionin përkatës në fushën e shëndetit, çështjeve sociale dhe mbrojtjes së fëmijëve, duke ngritur një grup pune ndërsektorial për hartimin e protokolleve të punës ndërmjet këtyre fushave ;
- institucionet përgjegjëse shtetërore, që veprojnë në këtë fushë, si p.sh njësitë për mbrojtjen e fëmijëve, shërbimet komunitare të shëndetit mendor, shërbimet ditore për fëmijë në nivel vendor, shërbimet arsimore, si edhe shërbimet shëndetësore parësore, etj., duhet të koordinojnë, bashkëpunojnë dhe bashkërendojnë punën për trajtimin, mbrojtjen, integrimin dhe monitorimin e gjithë procesit në interesin më të lartë të fëmijës, në zbatim të udhëzimit nr.10, datë 25.2.2015 "Për mënyrat, format e bashkëpunimit dhe procedurat e ndërhyrjes në ndihmë të fëmijëve në rrezik për institucionet dhe strukturat kryesore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës";
- Instituti i Shëndetit Publik duhet të realizojë studime, me qëllim sigurimin e të dhënave sasiore dhe cilësore, të cilat do të ndihmojnë në hartimin e politikave parandaluese dhe integruese.

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr. 8454 datë 4. 2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, organet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandime, duhet t’i shqyrtojnë ato dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin dhe, në vijim të bashkëpunimit, ndërmjet institucioneve tona, në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës, lutemi shqyrtimin e këtyre rekomandimeve.

K O M I S I O N E R

Nejla PEKA